

VENDIM
Nr.1032, datë 8.10.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË PËRMET, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Përmet, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 415 (katërqind e pesëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Përmet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Përmet

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
132-136,139,140,145,146, 148,152,154,155,158-162, 165,166,168-170	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
1,3-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
17-34	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
38-41	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
43	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
54,55	Varrezat publike	Në pronësi
56-79,195-218,351-403,411- 415	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
176-182	Prona në fushë e furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
232-239,241-347	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
406-410	Toka bujqësore joproductive	Në pronësi

45-53,348	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
-----------	---	------------